

KONTRATË
SHIT – BLERJE KUOTE

Sot, më datë 31/10/2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë), u paraqitën Shitësit dhe Blerësi, të cilët ranë dakord për hartimin e kësaj Kontrate me termat e mëposhtme:

SHITËSI:

Maksim R. Haxhia, shtetas shqiptar, i biri i Rustemit dhe i Rukies, i lindur më 03.05.1958, në Gjirokastrë, banues në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me kartën e identitetit Nr. 025325596, ortak i shoqërisë Max Energy sh.p.k, regjistruar sipas legjislacionit shqiptar me nr. NIPT L77003205H.

BLERËSI:

Renis Haxhia, shtetas shqiptar, i biri i Maksimit dhe i Etlevës, i lindur më 14.07.1989, në Tiranë, banues në adresën Zibrak, rruga Kuvajt, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me kartën e identitetit Nr. 025325595 dhe numër personal I90714072M.

PËRMBAJTJA E KONTRATËS

Z. Maksim R. Haxhia është ortak i shoqërisë Max Energy sh.p.k, regjistruar sipas legjislacionit shqiptar me nr. NIPT L77003205H, dhe dëshiron të shesë kuotën e zotëruar prej tij në shoqërisë në tërësinë e saj prej 52% të kapitalit, dhe blerësi Z. Renis Haxhia kërkon të blejë kuotën që përfaqëson 52% të kapitalit të shoqërisë.

Me vendimin e datës 31/10/2019 të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë Max Energy sh.p.k u vendos shitja e kuotës në masën 52% të kapitalit themeltar të shoqërisë Max Energy sh.p.k nga Ortaku Maksim R. Haxhia dhe blerja e kësaj mase nga ana e blerësit të ri Z. Renis Haxhia.

OBJEKTI

Objekt i kësaj kontrate është shitja e kuotës së kapitalit të shoqërisë “Max Energy sh.p.k.” në masën prej 52% të kapitalit themeltar, kuotë e cila zotërohet nga ortaku i shoqërisë Z. Maksim R. Haxhia, me cilësinë e shitësit dhe blerja e tyre nga Renis Haxhia në cilësinë e blerësit në këtë kontratë.

Shitja e kuotës së mësipërme, e cila përbën 52% të kapitalit themeltar të Shoqërisë “Max Energy sh.p.k.” sjell humbjen e së drejtës së pronësisë së ortakut z. Maksim R. Haxhia mbi 28% të kapitalit të shoqërisë si dhe cilësinë e ortakut të saj. Si pasojë e këtij transaksioni shitjeje, blerësi përfiton cilësinë e Ortakut të shoqërisë dhe pronësinë në masën 52% të kapitalit të shoqërisë.



KALIMI I PRONËSISË MBI KUOTËN

Transferimi i së drejtës së pronësisë mbi kuotën do të jetë njëkohësisht me nënshkrimin e kësaj kontrate.

Pas realizimit të këtij operacioni shit-blerje kuotash, sipas kësaj kontrate, struktura e kapitalit të shoqërisë tregtare "Max Energy sh.p.k", do të jetë si më poshtë:

1. Z. Renis Haxhia, zotëron 1 (një) kuotë, në masën 52 % të kapitalit themeltar të shoqërisë "Max Energy sh.p.k".
2. Z. Egi Santo zotëron 1 (një) kuotë, në masën 28 % të kapitalit themeltar të shoqërisë "Max Energy sh.p.k."
3. Shoqëria Seman Sunpoëer sh.p.k zotëron 1 (një) kuotë, në masën 20 % të kapitalit themeltar të shoqërisë "Max Energy sh.p.k".

ÇMIMI I SHITJES SË KUOTËS

Çmimi i këtij transaksioni shit – blerje kuote të shoqërisë të shoqërisë "Max Energy sh.p.k." do të jetë shuma prej 5200 (pesë mijë e dyqind) lek, vlera e kuotës së kapitalit themeltar të shoqërisë.

Palët deklarojnë se e gjithë vlera e kësaj kontrate është paguar në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe palët nuk do të kenë sot apo në të ardhmen asnjë pretendim mbi vlerën e shitjes.

DISPOZITA TË FUNDIT


Ligji i zbatueshëm është shqiptar. Për çdo gjë që nuk parashikohet në këtë kontratë do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.

Kontrata hartohet në 4 kopje të njëjta në gjuhën shqipe nga të cilat një e mbajnë palët, një kopje depozitohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, një kopje depozitohet në aktet e shoqërisë.

PALËT

SHITËSI

Maksim R. HAXHIA



BLERËSI

Renis HAXHIA

